

**Të nderuar studentë,**

**Shumë të dashur familjarë e të afërm të studentëve,**

**I nderuar personel akademik i Universitetit të Elbasanit,**

**Të nderuar kolegë rektorë dhe dekanë,**

**Të nderuar të ftuar,**

Ju uroj mirëseardhjen në Ceremoninë e Diplomimit të Universitetit të Elbasanit për vitin akademik 2021-2022.

Kjo ceremoni është një rast i veçantë për institucionin tonë, që kulmon me kurorëzimin e një cikli të gjatë sfidash, përkushtimi dhe përpjekjesh. Një kufi simbolik që shënon fundin e një udhëtimi dhe fillimin e një rrugëtimi të ri.

Ju studentë të diplomuar, nuk jeni thjesht gjenerata e të diplomuarve 2021-2022, por jeni edhe gjenerata e një pandemie që do të ndryshonte normalitetin tonë, gjenerata e sakrificës, që u testua dhe u sprovua nga sfida të vazhdueshme.

Këmbëngulja, durimi dhe aftësia juaj për t'u përshtatur dhe mbështetur njëri-tjetrit ndonëse në distancë, bëri të mundur kapërcimin e këtyre sfidave. Në këtë rrugëtim të vështirë për ju, jemi përpjekur si institucion për t'u përshtatur me modelet më të reja të mësimdhënies dhe për të lehtësuar kalimin nga mësimdhënia fizike në atë virtuale, duke u përgjigjur me profesionalizëm dhe bashkëpunim të vazhdueshëm.

Rrugëtimi ynë, ka qenë i gjatë dhe përgjatë këtyre viteve, kemi arritur të mësojmë se disa nga mësimet më të mëdha, nuk gjenden vetëm në libra, por në përvojat e përbashkëta. Ndërsa ecim përpara, përkushtimi dhe qëndrueshmëria e gjeneratave është një kujtesë, se pengesat që mund të ndeshim në rrugëtimin tonë, janë të kapërcyeshme vetëm nëse përpiqemi të kultivojmë unitetin dhe bashkëpunimin në angazhimin tonë.

Veprimtaria jonë si institucion nuk është e fokusuar vetëm në ofrimin e njohurive, por edhe në krijimin e një mjedisi të sigurtë, të larmishëm dhe gjithëpërfshirës për studentët tanë, si dhe t'i fuqizojë ato me aftësitë dhe vlerat e nevojshme për t'u bërë profesionistë të së ardhmes.

Kjo është bërë e mundur, duke ofruar një infrastrukturë të kompletuar, kurrikula bashkëkohore, kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik, pasurimin e laboratoreve në të gjitha fakultetet për formimin praktik dhe didaktik, biblioteka digjitale e shumë të tjera.

Falë nxitjes dhe mbështetjes së vazhdueshme është realizuar pjesëmarrja në shkëmbime me bashkëmoshatarët e studentëve në universitetet partnere, pjesëmarrja në trajnime, kualifikime, konferenca shkencore, veprimtari vullnetarizmi dhe nisma sociale.

Për të kontribuar në aftësimin praktik dhe për t'i afruar ato më shumë me tregun e punës, kemi ngritur Bordin Këshillimor të Biznesit, i cili organizon vazhdimisht trajnime dhe work-shope për studentët. Gjithashtu, ne jemi ndjerë krenarë me punimet cilësore të realizuara prej studentëve në Buletinin e Edicionit Special. Përfitoj nga rasti për të falenderuar edhe personelin akademik, udhëheqja e të cilit u ka hapur shtigje të reja studentëve tanë në rrugën e zhvillimit të kërkimit shkencor.

Arritjet dhe sukseset e Universitetit të Elbasanit, janë të panumërta dhe realizimi i tyre nuk do të ishte i mundur pa angazhimin dhe përkushtimin e palodhur të gjithë personelit akademik, stafit administrativ, si dhe institucioneve partnere nga vendi e bota, që kanë kontribuar vazhdimisht përgjatë këtyre viteve.

Një falenderim të veçantë dëshiroj t'ja kushtoj të gjithë prindërve, që na besuan arsimimin e fëmijëve të tyre. Ndërkohë që sot, ju mburreni të entuziasmuar për arritjet e tyre, ne mburremi me krenari që ishim kontribues dhe dëshmitarë në suksesin e tyre.

Në këtë ceremoni kaq të rëndësishme, përfitoj për të kujtuar jubile, po aq të rëndësishëm për institucionin tonë që kulmuan në 2021, si **50-vjetori** i themelimit të Institutit të Lartë Pedagogjik, që u mbështet në traditën e përgatitjes së mësuesve në shkollën Normale të Elbasanit, **30-vjetori** i kthimit të Elbasanit në një qytet universitar, si dhe **25-vjetori** i botimit të numrit të parë të revistës periodike Buletini Shkencor, ku me mijëra akademikë dhe intelektualë, kanë publikuar hulumtimet e tyre dinjitoze në fusha të ndryshme. Këto, janë data që shënojnë historinë e universitetit, botën akademike dhe memorien kolektive.

Në fillim të hapjes së ceremonisë së diplomimit, ndoqët filmin e përgatitur nga stafi ynë me titull **“Unë zgjedh të arsimohem në vendin tim”**.

**Ky është mesazhi që duam të transmetojmë për të gjithë ju.**

**Le të punojmë sëbashku, për vendin tonë!**

Sot kjo sallë mirëpriti studentë, por në fund të kësaj ceremonie, do të përcjellë, mësues, personel mjekësor, ekonomistë, shkencëtarë, shkrimtarë, gazetarë, psikologë, profesionistë të së ardhmes, kontributi i të cilëve do të shihet në vijim.

Në përfundim të fjalës sime, bashkë me urimin për sa më shumë suksese të tilla, dëshiroj të citoj një shprehje të ish-presidentit amerikan Xhon Kenedi - **“Mos pyesni se çfarë mund të bëjë vendi juaj për ju - pyesni se çfarë mund të bëni ju për vendin tuaj.”**

**Suksese të gjithëve!**

**Prof. dr. Skender Topi**

**Rektor**